



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0005630-4/26, dt. 10.02.2026
Mitrovicë

02-060/01-0005630-4/26
10.02.2026

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, alinea d, dhe nenit 40, paragrafi 2, nënparagrafi d, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); dhe nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe nenit 46, paragrafi 1.4, të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 10.02.2026, sjell këtë:

VENDIM

Për formimin e Grupit punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026

1. FORMOHET Grupi Punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit për vitin 2026, në përbërje:
 - 1.1 Armend Begu
 - 1.2 Igballe Islami
 - 1.3 Elfate Ademi Bahtiri
 - 1.4 Xhulijeta Imeri
 - 1.5 Gjergj Beka
 - 1.6 Jeton Ujkani, dhe
 - 1.7 Flamur Vojvoda
2. Detyrë e Grupit Punues të formuar me pikën 1 të këtij vendimi është që në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë që ka Kuvendi i Komunës me dispozita të Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe dispozitave të ligjeve tjera, pjesët me kompetenca të komunës, aktet nënligjore dhe Statutin e Komunës, të hartojë Planin vjetor të punës së Kuvendit të komunës për vitin 2026.
3. Pas hartimit të planit të punës, të njëjtin do t'ia procedojë Kuvendit të Komunës për miratim.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit dhe Grupi Punues i formuar me këtë vendim.
5. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
1 x 1 MAPL-së
1 x 1 Arkivit
Kopje: Kryetarit të Komunës
Anëtarëve të komisionit.